



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.292/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi kryesues, Ferki Xhaferi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Edona Grajçevci, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Koalicioni AAK-PSD, me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, Anr.292/2019 e datës 05.10.2019, me të cilin ka kërkuar që koalicionit AAK/PSD, t'i shqiptohet dënim me gjobë për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore-postimit të fotove në rrjetin social Facebook.

A r s y e t i m

Paraqitësi i ankesës Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me datën 05.10.2019, ka paraqit ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se me datë 05.10.2019, gjatë ditës së heshtjes zgjedhore, koalicioni AAK/PSD, ka vazhduar sponsorimin e fushatës zgjedhore në rrjetin social facebook, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore. Më këtë rast pretendohet se është bërë thyerja e heshtjes zgjedhore, të përcaktuar me LZP. Me propozim për PZAP-in, që ankesa të miratohet e bazuar.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografisë së bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës vërtetohet fakti se nga fotografia e postuar në llogarinë e kandidatëve për deputet Brahim Mehmetaj, Donika Kadaj, Grant Shala dhe Labinot Tahiri, nga radhët e koalicionit politik AAK/PSD, në rrjetit social facebook, përmes të cilës është bërë fushatë zgjedhore.

Prova e vetme e dorëzuar nga ankuesi që është disa fotografi te postuara në llogarinë e kandidatëve në fjalë në rrjetin social facebook, si dhe katër video incizime nuk ka datë të postimit (kur është postuar), pra nuk mund të identifikohet pretendimi i parashtruesit të ankesës se nga ana e koalicionit politik AAK/PSD, është thyer heshtja zgjedhore përmes veprimit/ sponsorizimit të fushatës zgjedhore me anë të postimit të fotografisë në llogarinë e kandidatëve të lartëcekur, në rrjetin social facebook, në mungesë të argumentimit të datës së postimit.

Paneli, vlerëson se në bazë të fotografive dhe video incizimeve të prezentuara si provë materiale, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, nuk mund të konstatohet qartë dhe bindshëm siç përcaktohet me nenin 117 parag.3 të LZP-së, për të provuar se shkelësi i supozuar ka shkelur Kodin e Mirësjelljes, përmes thyerjes së heshtjes zgjedhore me datë: 05.10.2019, përmes të bërit fushatë në çfarëdo mënyre.

Ditën e shqyrtimit të këtyre ankesave, paneli ka hetuar nëse sponsorizimet e supozuara janë aktive por që nuk ka qenë e mundur të vërtetohet në rrugë elektronike nëse të njëjtat një ditë më parë kanë qenë aktive dhe në kohën e testimin të njëjtat kanë qenë jo aktive.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e konform nenit 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.292/2019 më datën 06.10.2017

Kryesuesi i Panelit
Rrustem Thaqi



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*